Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 527/01
Datë 14.12.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 14.12.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ri akreditimin dhe ri validimin e Qendrës për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi", Gjakovë për periudhën: 14.12.2015 deri 14.12.2018 për të ofruar:

1.1. Asistent Administrativ, niveli IV i KKK

2. Ri akreditimi dhe ri validimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Qendra të finalizojë databazën e të dhënave për biznes duke përfshirë manualin dhe procedurat e përdorimit duke përfshirë edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit nivel të përdoruesve në kuadër të databazës;
- Qendra të zhvilloj një plan të përmirësimit të mungesave të paarsyeshme të nxënësve;
- Qendra të vendos sistemin e shenjëzimit në infrastrukturën e saj, duke përfshirë edhe udhëzimet për dalje në rast të rreziqeve;
- Menaxhmenti të përcaktoj kriteret për shpërndarjen e bursave socio-ekonomike;
- Në përshkrimin e vendit të punës së koordinatorit të cilësisë të definohen detyrat dhe përgjegjësitë e tij në aspekt të rolit si psikolog/sociolog;

- Të rishikoj numrin e kredive për punë praktike dhe ti përshtat konform kredive;
- Qendra të zhvilloj një sistem të freskimit të dokumentacionit të stafit. Kjo për faktin se disa prej mësimdhënësve janë identifikuar të kenë pranuar licencat nga MASHT përderisa nuk kanë sjellë kopjet në Qendër për tu arkivuar;
- Qendra të vendos shkallët emergjente në objekt.

Afati kohor për plotësimin e kushteve është: 01.04.2016

3. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Ri validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Ri akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

3.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

5. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

6. Vendimi i dërgohet:

- Qendrës për Arsim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi" , Gjakovë;
- AKK.

Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani